



ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr1 i prokurimit	622-20-2054-1-1-1
Nr i brendshëm	622-20-027-111

Sa i përket tenderit për: **Furnizim me zhavorr për rrugët e pa asfaltuara në Komunën e Prizrenit**

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

NPN "RENELUAL TAHIRI" shpk-Prizren

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rruga e Jonit 92/2, Prizren

Prizren

20 000

(Vendi)

(Kodi postar)

044/128112

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Yll Hoxha

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

renelual_tahiri@hotmail.com

(Adresa elektronike)

23.06.2020

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” apo “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Njoftimi për Kontratë me dt. 15.05.2020

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave me dt. 26.06.2020

Kërkesa për rishqyrtim: 19.06.2020

Vendimi i AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim: 22.06.2020

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☐

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit?
A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit
tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë
fakt:*

Po

☐

Jo

☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

☐

Jo

☐

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së

Neni 27 i LPP-së

Neni 69 i LPP-së

Neni 18.9 i RRUOPP-së

Neni 26.4 i RRUOPP-së

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar fillimisht po ju rikujtojmë se ky aktivitet i prokurimit është Ri tenderim, ndërsa ne kemi qenë ofertues edhe në herën e kaluar dhe kemi kaluar në procese të ankesave ku në herën e fundit është marrë vendim nga paneli shqyrtues i OSHP-së (Psh.08,22,26/20 i dt.11.03.2020), që të vërtetohet njoftimi i AK-së për anulim të këtij aktiviteti të prokurimit me arsyetimin se nuk ka pasur ofertues të përgjegjshëm.

Pas vendimi të OSHP-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit, autoriteti kontraktues e ka ri tenderuar këtë aktivitet të prokurimit duke i ashpërsuar kriteret dhe duke i rritur edhe më tepër kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale.

Është për tu çuditur ky vendim i AK-së për ashpërsimin e kriterëve/kërkesave, duke e pasur parasysh se tenderi paraprak ka dështuar dhe është anuluar në mungesë të ofertuesve të përgjegjshme për shkak të mosplotësimit të kërkesave të dosjes së tenderit, saktësisht për shkak të mosplotësimit të kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale.

Ndërsa tani në vend se të reduktohen kërkesat nga ana e AK-së në mënyrë që të mundësohet një pjesëmarrje sa më e gjerë e operatorëve ekonomik dhe në vend se të hapet ose rritet konkurrenca, AK-ja me kërkesat aktuale e ka kufizuar konkurrencën dhe njëkohësisht e ka favorizuar një kompani të caktuar duke ia përshtatur kërkesat kësaj kompanie, e të cilën kompani e keni favorizuar dhe jeni munduar ta favorizoni deri në fund të procesit paraprak.

Tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale tek neni 9.1&9.2 i FDT-së, keni kërkuar "lista e projekteve të natyrës së kontratës e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skanuar nga origjinali) për dosjen elektronike, të dëshmuara me referenca dhe kontrata të cilat dëshmojnë vlerën e furnizimeve dhe natyrën e tyre apo procesverbal të pranimit përfundimtar të furnizimeve".

Kjo kërkesë është kundërthënëse sepse në fillim të fjalisë thuhet lista e projekteve të natyrës së kontratës, ndërsa në fund të kësaj kërkesë thuhet se duhet të dëshmohet me vlerën furnizimeve dhe natyrën e tyre. Pra në këtë rast ka kundërthënie ndërmjet fjalive të lartcekura sepse natyra e kontratës dallon me fjalën furnizime, ndërsa natyra e kësaj kontrate nuk ka të bëjë vetëm me furnizime me zhavorr siç është titulluar ky projekt, por kur analizohet paramasa shikohet se në brendi të saj përfshihen edhe transporti i materialeve, pastrimi i terenit, gjurmimi dhe hapja e kanaleve, gjurmimi dhe planifikimi i rrugëve, pastrimi dhe punimi i kanaleve të hapura në formë trapezi për largimin e ujërave atmosferike dhe sipërfaqësore të rrugës, furnizimi me material si dhe punimi i armaturës, prerja, lakimi dhe vendosja sipas pozicioneve si dhe standardeve teknike, furnizimi me gypa të madhësisë së ndryshme etj.

Pra në këtë paramasë parashihen pothuajse të gjitha punimet dhe furnizimet që kanë të bëjnë me asfaltim të rrugëve, ndërtim të ndryshme, kanalizime etj. prandaj edhe kërkesa në lidhje me dëshmitë për listën e kontratave dhe referencave duhet të ndryshohet dhe të kërkojnë referenca apo procesverbale të pranimeve

përfundimtare të natyrës së ngjashme, e jo siç e ka cekur AK-ja për furnizim, sepse kërkesa e tillë për furnizim është e destinuar për favorizim të kompanive të caktuara dhe natyrisht është kërkesë diskriminuese për kompanitë tjera.

Siç e dini edhe ju vetë, në punimet e asfaltimit dhe kubzimit të rrugëve (**asfalti dhe kubëzat prodhohen nga zhavori**), ndërtime të ndryshme, kanalizime etj. ka furnizime me zhavorr, prandaj në këtë rast kërkesa dhe dëshmia e kërkuar dokumentare nga AK-ja duhet të ndryshohet dhe të kërkohet (riformulohet) kontrata të ngjashme dhe referenca apo procesverbale për punë të ngjashme, e jo veç për furnizime.

Ju sqarojmë se kjo kërkesë e vendosur në FDT është favorizuese për kompani të caktuara të cilat kryejnë punë vetëm me furnizim me zhavorr, e që në Kosovë janë shumë të rralla kompanitë që merren vetëm me këtë veprimtari dhe që mund ta plotësojnë këtë kërkesë me këtë vlerë të kontratave, ndërsa nëse e shikojmë paramasën shihet qartë se nuk kemi të bëjmë vetëm me furnizim me zhavorr.

Edhe në lidhje me këtë kërkesë AK-ja ka vepruar në mënyrë subjektive duke e kufizuar konkurrencën dhe duke favorizuar kompani të caktuara, pasi që kërkesa e mëhershme (në aktivitetin e kaluar të anuluar) ka qenë se duhet të ofrohet Lista e projekteve të natyrës së kontratës e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skanuar nga origjinali) për dosjen elektronike, të dëshmuara me referenca të cilat dëshmojnë vlerën e punëve dhe natyrën e tyre apo proces verbal të pranimit përfundimtar të punëve. Pra në aktivitetin që është anuluar kërkesa ka qenë që të ofrohet dëshmi për vlerën e natyrës së kontratës ndërsa tani AK-ja e ka kufizuar edhe më shumë duke kërkuar dëshmi vetëm për furnizime dhe natyrën e tyre.

Prandaj kjo kërkesë duhet të ndryshohet me qëllim që të zgjerohet mundësia e ofertimit e sa më shumë operatorëve ekonomik dhe me qëllim të hapjes së konkurrencës.

AK-ja në paramasë tek Kategoria A në pozicionet 1-5 ka përcaktuar që furnizimi me gurë të thyer dhe me gurë natyral nga gurëthyesi ose deponia deri në 15 km, mirëpo ne konsiderojmë se kjo kërkesë është shumë favorizuese/diskriminuese në aspektin territorial sepse favorizohen kompanitë brenda territorit prej 15 kilometrave, ndërsa diskriminohen kompanitë tjera jashtë 15 kilometërsh. Në këtë rast e rëndësishme është që operatorët ekonomik ofertues ta kenë në posedim deponinë/gurëthyesin ose të kenë marrëveshje bashkëpunimi me ndonjë kompani, mirëpo jo edhe të caktohen kilometrat kufizues sepse kilometrat nuk e përcaktojnë cilësinë e punës apo furnizimit. Gjithashtu janë çështje tjera nëse kompanitë që kanë bazën më larg kanë llogari të ofertojnë në këtë aktivitet të prokurimit dhe ju takon atyre ta bëjnë këtë analizë dhe këtë përllogaritje për vendosjen e çmimeve për pozicionin përkatës. Prandaj nuk ka asnjë bazë ligjore ky kufizim territorial dhe nuk ka asnjë arsye logjike apo profesionale caktimi i 15 km nga gurëthyesi ose deponia. Këto përcaktime dhe kufizime të kilometrave duhet të largohen me qëllim të trajtimit të barabartë të gjithë ofertuesve dhe me qëllim të mos favorizimit të kompanive të caktuara në aspektin territorial. Pra duhet të ndryshohet kjo kërkesë dhe të mbetet në përgjegjësi të operatorëve ekonomik mundësia dhe llogaria e marrjes pjesë në këtë aktivitet të prokurimit, thjesht të mbetet në përgjegjësi të operatorëve ekonomik se a kanë interes dhe mundësi të ofertimit në këtë aktivitet të prokurimit, pavarësisht distancës apo largësisë që e kanë nga gurëthyesi apo deponia.

Pas ri tenderimit, AK-ja në paramasë ka bërë disa ndryshime nga hera e kaluar, duke duplikuar dhe dyfishuar disa pozicione dhe duke ju përcaktuar poena këtyre pozicioneve edhe pse disa pozicione është dashur të inkorporohen-të përfshihen në një vend.

P.sh tek **Kategoria A-** pozicioni **Nr.1-Furnizim me zhavorr**, janë parashikuar furnizimi me gurë të thyer FR.0-4 mm nga gurëthyesi ose deponia deri në 15 km,

Pozicioni **Nr.2-** janë parashikuar furnizimi me gurë të thyer FR.4-8 mm nga gurëthyesi ose deponia deri në 15 km,

Pozicioni **Nr.3-** janë parashikuar furnizimi me gurë të thyer FR.0-31.5 mm nga gurëthyesi ose deponia deri në 15 km,

Pozicioni **Nr.4-** janë parashikuar furnizimi me gurë të thyer FR.0-63 mm nga gurëthyesi ose deponia deri në 15 km,

Pozicioni **Nr.5-** janë parashikuar furnizimi me gurë të thyer FR.0-150 mm nga gurëthyesi ose deponia deri në 15 km, ku është parashikuar që kjo kategori ti ketë 35 % të pikëve.

Ndërsa **Kategoria C-Furnizim dhe shërbime me Zhavor** –Pozicioni **Nr.1** janë parashikuar furnizimi me gurë të thyer FR.0-31.5 mm

Pozicioni **Nr.2** janë parashikuar furnizimi me gurë të thyer FR.0-63.0 mm

Pozicioni **Nr.3** janë parashikuar furnizimi me gurë të thyer FR.0-150 mm, kurse në pozicionet tjera prej 4-8 janë parashikuar transporti i materialeve, pastrimi i terenit, shtruarja, ngjeshja e gurit, gërmimi, transporti i makinerive etj. ku është parashikuar që kjo kategori ti ketë 20% të pikëve të vlerësuara.

Duke u bazuar në pozicionet të cilat u cekën më lartë është e pakuptimtë, e panevojshme dhe e paarsyeshme, e jo profesionale kjo ndarje e pozicioneve dhe e vendosjes së pikëve për furnizimet me gurë të thyer të njëjtë, në kategorinë A janë parashikuar veçantë furnizimet me gurë të thyer me fraksione të ndryshme, ndërsa tek kategoria C është vendosur vetëm titulli furnizimi dhe shërbime me zhavor, mirëpo pozicionet 1-3 në këtë kategori (C) parashihet vetëm furnizim me gurë të thyer me fraksione të cilat janë parashikuar tek pozicionet 3, 4, 5 tek kategoria A, prandaj këto pozicione për furnizime me gurë të thyer të fraksioneve të njëjta është dashur të parashikohen vetëm në një kategori dhe të përfshihen në tri pozicione eventuale brenda kësaj kategorie, e jo të vendosen dhe të parashikohen furnizimet e njëjta me gurë të thyer me fraksione të njëjta në dy kategori të ndryshme dhe në pozicione të ndryshme, sepse kështu siç është përpiluar paramasa krijohet mundësia shumë e madhe e favorizimeve të kompanive të caktuara me rastin e ofertimit dhe mundësia shumë e madhe e manipulimeve në vlerësim dhe shpallje të fituesit, e shumë më shumë është mundësia e manipulimit gjatë implementimit të kontratës kur ka pozicione pothuajse të njëjta të ndarë në kategori të ndryshme. P.sh operatori ka mundësi të jep çmime të ndryshme por pozicionet të cilat në realitet janë të njëjta, kurse gjatë implementimit mund të kërkohet nga OE nënshkrues i kontratës që të bëjë furnizime me gurë të thyer në ndonjërin pozicion që ka ofruar çmim më të lartë.

Prandaj kërkojmë nga ju që të detyroni AK-në që të ri formulon paramasën në kategoritë që u përmendën dhe në pozicionet të cilat janë dyfishuar në mënyrë jo profesionale, të ndryshohet dhe të përmirësohet me qëllim të qartësisimit më të madh dhe mos kufizimit të kërkesave të cilat nuk kanë ndonjë rëndësi në këtë rast. Pra po kërkojmë edhe që të mos ju jepet pikë pozicioneve të njëjta nëpër kategori të ndryshme, por furnizimet që bëhen me gurë të fraksione të ndryshme vetëm njëherë të poentohen, e jo dy herë siç e ka përcaktuar AK-ja.

Gjithashtu tek Kategoria **B-Furnizim me Gypa**, janë parashikuar furnizimi me gypa betoni sipas diametrave tek pozicionet 1.1 Ø 1000; 1.2 Ø 800; 1.3 Ø600; 1.4 Ø500; 1.5 Ø 400, ku është parashikuar që kjo kategori ti ketë 30% të pikëve të vlerësuara.

Tek kategoria **D-Furnizim dhe shërbime me Gypa**, tek numri 2 janë parashikuar furnizimi dhe montimi i gypave nga betoni i armuar me diametër tek pozicionet 2.1 Ø 1000; 2.2 Ø 800; 2.3 Ø600; 2.4 Ø500; 2.5 Ø 400, ku është parashikuar që kjo kategori ti ketë 10% të pikëve të vlerësuara duke përfshi edhe dy pozicione tjera.

Për neve është e pakuptimtë, e panevojshme dhe e paarsyeshme, e jo profesionale kjo ndarje e pozicioneve dhe e vendosjes së pikëve për furnizimet e gypave të njëjtë, në kategorinë B janë parashikuar veçantë furnizimet me gypa përkatës, ndërsa tek kategoria D furnizimi dhe montimi i gypave të njëjtë, ndërsa ne kërkojmë që këto pozicione të vendosen në një kategori ku mund të përfshihen furnizim dhe montimi i gypave përkatës dhe të iu caktohet një vlerësim i parashikuar apo i përcaktuar nga AK-ja i pikëve, sepse në këtë mënyrë është mundësia shumë e madhe favorizimeve të kompanive të caktuara me rastin e ofertimit dhe e manipulimeve në vlerësim dhe shpallje të fituesit, e shumë më shumë është mundësia e manipulimit gjatë implementimit të kontratës kur ka pozicione pothuajse të njëjta të ndarë në kategori të ndryshme. P.sh operatori ka mundësi të jep çmime të ndryshme por pozicionet të cilat në realitet janë të njëjta, kurse gjatë implementimit mund të kërkohej nga OE nënshkruar i kontratës që të bëjë furnizime me gypa në ndonjërin pozicion që ka ofruar çmim më të lartë.

Duke pasur parasysh këto pretendime dhe fakte tona të cekura më lartë kërkojmë nga ju që të detyroni AK-në që të ri formuloj paramasën në kategoritë dhe pozicionet që u cekën më lartë, të ndryshohet dhe të përmirësohet me qëllim të qartësisimit më të madh dhe mos kufizimit të kërkesave të cilat nuk kanë ndonjë rëndësi në këtë rast. Pra po kërkojmë edhe që të mos ju jepet pikë pozicioneve të njëjta nëpër kategori të ndryshme, por furnizimet që bëhen me gypa të ndryshëm vetëm njëherë të poentohen, e jo dy herë siç e ka përcaktuar AK-ja.

Ne me dt. 22.06.2020 kemi marrë përgjigje në kërkesën për rishqyrtim ku autoriteti kontraktues ka deklaruar se refuzohet kërkesa për rishqyrtim, mirëpo nuk ka dhënë asnjë përgjigje faktike dhe ligjore për refuzimin e kërkesë tonë për rishqyrtim.

Në lidhje me pretendimin tonë për kontrata dhe referenca të natyrës së kontratës-furnizimeve, AK-ja si arsye të refuzimit të kërkesës tonë për rishqyrtim e ka cekur se *"1.Autoriteti kontraktues nuk ka formuluar dhe nuk ka vendosë kritere as diskriminuese e as favorizuese për asnjë OE. Përkundrazi ka kërkuar referenca të natyrës së kontratës E NATYRA E KONTRATËS EDHE SIPAS NUMRIT TË PROKURIMIT 111 EDHE SIPAS FORMULIMIT TË TITULLIT ËSHTË FURNIZIM ME ZHAVORR PËR RRUGËT E PAASFALTUARA NË KOMUNËN E PRIZRENIT.*

Në lidhje me këtë arsye të AK-së, ju sqarojmë se numri i prokurimit të cilin e ka përmendur AK-ja 1-1-1 (furnizim, procedurë e hapur, vlerë e madhe) është shumë e qartë se numri tregon se aktiviteti i prokurimit ka të bëjë me furnizim dhe ne nuk e kemi kontestuar numrin e aktivitetit të prokurimit ku kuptohet që ky aktivitet ka të bëjë me furnizime, por pretendim i yni ka qenë se kërkesa e lartpërmendur është kundërtënëse sepse në fillim të fjalisë thuhet lista e projekteve të natyrës së kontratës, ndërsa në fund thuhet se duhet të dëshmohet me vlerën furnizimeve dhe natyrën e tyre. Pra në këtë rast ka kundërtënie ndërmjet fjalive të lartcekura tek dëshmia e kërkuar dokumentare sepse natyra e kontratës dallon me fjalën furnizime, ndërsa natyra e kësaj kontrate nuk ka të bëjë vetëm me furnizime me zhavorr siç është titulluar ky projekt, pra pretendim i yni ka qenë që dëshmia e kërkuar dokumentare duhet të ndryshohet (riformulohet) dhe të

kërkohen kontrata të ngjashme dhe referenca apo procesverbale për punë të ngjashme, e jo veç për furnizime, andaj arsyeja e lartpërmendur e AK-së për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim është e pa bazuar dhe me tendenca të shmangies nga pretendimi jonë ankimor, duke tentuar të zhvendos vëmendjen nga pretendimi jonë konkret i cili ka të bëjë me mospërputhje të kërkesave në lidhje me dëshmitë dokumentare dhe me zgjerim të kërkesës për të ofruar dëshmi për përfundim të punëve në lëminë e ngjashme, tek numri i prokurimit që ka të bëjë me furnizim.

Kjo kontratë-ky aktivitet i prokurimit nuk ka të bëjë 100% me furnizime por ka të bëjë edhe me punë e shërbime, pra është kontratë e kombinuar, prandaj në këtë rast emërtimi mund të bëhet furnizim me zhavorr por kërkesat/dëshmitë për kontrata dhe referenca duhet të kërkohen të ngjashme e jo vetëm për furnizime, sepse është favorizuese kjo kërkesë, ndërsa neni 15.3 i RRUOPP parasheh qartë klasifikimin e kontratës ku shkruan *"Megjithatë, është e mundshme për një kontratë publike të jetë "kombinim": Furnizim/Shërbim, Punë/Shërbim; Punë/Furnizim; kombinim në Furnizim/Punë/Shërbime. Metoda bazike për të trajtuar këtë ndarje është gjithnjë modeli i kostos së thjeshtë. Cilido element i kontratës që ka shpenzimet më të larta të parashikuara kontrata duhet të klasifikohet nën atë lloj të kontratës"*.

Prandaj edhe në këtë rast mund të ketë më shumë furnizime, mirëpo kërkesat dhe dëshmitë në lidhje me kontrata dhe referenca duhet të hartohen dhe të formulohen në atë mënyrë që të mos kufizojnë konkurrencën dhe të mos favorizojnë operatorët ekonomik të caktuar.

Në lidhje me pretendimin tonë se AK-ja i ka dyfishuar disa pozicione, duke ju përcaktuar poena këtyre pozicioneve edhe pse disa pozicione është dashur të inkorporohen-të përfshihen në një vend, pozicione këto të cilat i kemi përmendur më lartë, AK-ja ka dhënë përgjigje si në vijim :*Grupimi te oferta me poentim është bërë nga ana e AK dhe e njëjta është për të gjithë OE të interesuar njësoj, edhe këtu nuk ka kurrfarë diskriminimi, ËSHTË VËREJTË MË VONË QË NË PARAMASA TE POENTIMI KA FORMULA TË FSHEHTA TË CILAT DUHET TË FSHIHEN. PRA JU NUK DUHET TË BAZOHI NË ATO FORMULA POR ÇMIMET PËR POENTIM DUHET TI KALKULONI NË BAZË TË PËRQINDJES SË DHËNË TE PARAMASAT"*.

Sa i përket kësaj arsyeje për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim ju sqarojmë se AK-ja vetë e ka pranuar se ka gabime në paramasë, ndërsa në anën tjetër thotë se nuk ka kurrfarë diskriminimi sepse paramasë është e njëjtë për të gjithë, mirëpo pretendim i yni nuk ka qenë për formulat e fshehta të cilat i ka cekur AK-ja sepse nuk i kemi vërejtur ato, por pretendim i yni ka qenë se AK-ja ka duplikuar dhe dyfishuar disa pozicione, duke ju përcaktuar poena këtyre pozicioneve edhe pse disa pozicione është dashur të inkorporohen-të përfshihen në një vend, andaj kjo arsye e AK-së është e pa bazuar dhe AK-ja është duke u munduar të devijojë nga pretendimet tona ankimore duke u munduar të fshehtë diskriminimin që po i bëhet disa operatorëve ekonomik dhe shumë kompanive tjera dhe favorizimin që po i bëhet kompanisë së caktuar. Prandaj kërkojmë që edhe formulat (të cilat i referohet AK-ja) të korrigjohen dhe mos të ketë gabime sepse pastaj gjatë ofertimit mundësia është shumë e madhe të ketë gabime aritmetike e të pësojnë operatorët ekonomik që ofertojnë e që nuk kanë informacione të brendshme nga AK-ja se ku janë gabimet.

Në lidhje me pretendimin tonë se AK-ja në paramasë tek Kategoria A në pozicionet 1-5 ka përcaktuar që furnizimi me gurë të thyer dhe me gurë natyral nga gurëthyesi ose deponia deri në 15 km, AK-ja në vendimin e tyre për refuzim të kërkesës për rishqyrtim është përgjigjur si në vijim *"Nuk ka kufizim të lartësisë së gurthyesit as në Dosje të tenderit e as në njoftim për kontratë, andaj kufizimet në paramasa nuk qëndrojnë dhe të njëjtat do të përmirësohen. Të gjitha vërejtjet tjera të bëra nga ana juaj janë çështje teknike të cilat i*

rregullon dhe i grupon autoriteti kontraktues e nuk janë diskriminuese ose favorizuese për një OE por janë të njëjta për të gjithë”.

Lidhur me përgjigjen e lartpërmendur të AK-së, ju sqarojmë se ne si kompani nuk kemi përmendur lartësi por largësinë e gurëthyesit. AK-ja në njërën anë po thotë se nuk ka kufizime ndërsa në anën tjetër do të përmirësohen kufizimet, madje vetë AK-ja e ka ndryshuar paramasën në pikën që ne e kemi konsideruar si diskriminuese/favorizuese ku në vend të fjalisë në pozicionet 1-5 ka përcaktuar “furnizimi me gurë të thyer nga gurëthyesi ose deponia deri në 15 km”, ka vendosur fjalinë si në vijim “**Furnizimi me gurë të thyer nga gurëthyesi apo deponia**”. Pra vetë AK-ja ka bërë ndryshime në paramasë e që faktikisht i bie se neve na është aprovuar njëri pretendim ankimor edhe pse AK-ja në vendimin e tyre ka marrë vendim që të Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik të “NPN Renelual Tahiri”. **Prandaj për këtë arsye ky pretendim mbetet pjesë e ankesës.**

Pra edhe në vendimin e AK-së vërehen mospërputhje ndërmjet dispozitivit dhe arsyetimit dhe njëkohësisht veprimeve të tyre duke e tendosur edhe më shumë procesin e këtij aktiviteti të prokurimit.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe kundërshtimet tona që u cekën më lartë rezulton se autoriteti kontraktues nuk e ka përpiluar dosjen e tenderit në harmoni me nenin 27 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk e ka pasur parasysh as nenin 18.9 të RRUOPP ku shkruan qartë që “*Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk: Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE-ve.*

Pra duke u bazuar në të gjitha faktet që u cekën më lartë shihet tendenca e AK-së për dhënien e kontratës OE të caktuar, pasi që gjitha kërkesat e lartpërmendura i përshtaten vetëm një kompanie të caktuar.

Pra me këto kërkesa dhe dëshmi të kërkuara mundësia është shumë e madhe dhe pothuajse e pashmangshme e dëmtimit të buxhetit, sepse kompanitë e caktuara (favorizuese) mund të ofertojnë me çmime shumë më të larta dhe eventalisht të nënshkruajnë kontratë, pasi që në Kosovë dihet se kush mund ti plotësojë këto kërkesa dhe dëshmi dokumentare, prandaj mundësia e manipulimit me çmime kur përshtaten kërkesat është shumë e madhe.

Duke u bazuar në të gjitha ato kërkesa diskriminuese-favorizuese dhe në ato dëshmi të kërkuara, rezulton se në këtë mënyrë nuk mund të arrihet qëllimi i LPP-së, siç parashihet në nenin 1 të këtij ligji, e ku shkruan qartë: *Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.*

Kërkesat e lartcekura bien në kundërshtim me nenin 7 paragrafi 1, 3, 4 dhe 6 të LPP-së, sepse në këta paragraf parashihet qartë që operatorët ekonomik nuk mund të diskriminohen në asnjë mënyrë dhe në asnjë variant. Prandaj të gjitha kërkesat të cilat i kontestuar më lartë duhet larguar/ndryshuar për të pasur një aktivitet të prokurimit normal dhe për të mos u diskriminuar/favorizuar kompanitë e caktuara.

Kërkesat që u kundërshtuan më lartë, janë shumë favorizuese/diskriminuese dhe njëkohësisht ua mbyllin dyert e ofertimit pothuajse shumë kompanive dhe këto kërkesa janë në kundërshtim edhe me nenin 26.4 të Rregullave dhe Udhëzuesit operativ për prokurim publik, sepse aty shkruan qartë se “*Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do të kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike*”.

Pra autoriteti kontraktues në vend se të ketë parasysh edhe zhvillimin e operatorëve ekonomik të rinjë, AK-ja përveç se nuk e ka marr parasysh këtë dispozitë, i ka diskriminuar hapur edhe operatorët ekonomik tjerë më shumë përvojë në këtë fushë.

Autoriteti kontraktues pas dështimit paraprak të këtij aktiviteti të prokurimit, me rastin e ri tenderimit është dashur ta ketë parasysh arsyen e anulimit të këtij aktiviteti të prokurimit dhe është dashur të zvogëloj dhe ti zbut kriteret, kërkesat dhe dëshmitë e kërkuara dokumentare me qëllim që të bëhet një procedurë e rregullt e këtij aktiviteti të prokurimit dhe për të finalizuar këtë projekt, e jo të bëhen ndryshime drastike të kërkesave duke e bërë edhe më të ashpër dhe më kufizuese konkurrencën.

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE “NPN “RENELUAL TAHIRI”

DETYROHET autoriteti kontraktues që të ndryshoj kërkesat/paramasat, që u cekën më lartë nga ana jonë dhe pastaj të veprohet konform nenit 53 të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Dëmet materiale akoma nuk janë llogaritur sepse jemi në fazën e njoftimit për kontratë dhe fazën para ofertuese.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-së,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-së, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*